



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.6.	RREZIQET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
Nën-tema 2.6.3.	RRUGËT E TRAFIKUT NË VENDET E PUNËS
Ligji / rregulloret përkatëse:	<ul style="list-style-type: none">• Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës.
Shkurtesa:	• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolluese është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushëveprimin e zbatimit të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe bazat mbi të cilat kryhen puna ose trajnimi në vendet e punës ku ekziston rreziku për shëndetin, veçanërisht për aksidente të lidhura me trafikun në zonën e kompanisë. Kjo listë kontrolluese nuk përfshin rrugët e përgjithshme të trafikut jashtë vendeve të punës ose në vendpunishtet ndërtimore.
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	INSPEKTIMI I RREZIQEVE NË VENDET E PUNËS – RRUGËT E TRAFIKUT			
	<i>* Bëhuni shembull; respektoni rregulloret e sigurisë dhe shëndetit në lokacionin / vendet e punës të inspektuara!</i>			
	<i>* Gjatë vizitës në lokacion/vendin e punës kushtoni vëmendje aspekteve të përgjithshme ose organizimit të punës dhe proceseve, duke përfshirë paraqitjen e vendeve të punës dhe mjedisit rrethues, përfshirë cilësinë e dyshemesë që mund të kenë efekt në rreziqet e lidhura me sigurinë e trafikut.</i>			

	<p>* Merrni shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të rrugëve të trafikut dhe zonës së jashtme (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë).</p> <p>* Mbani mend:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ kushtojini vëmendje përdorimit praktik të rrugëve të trafikut (p.sh., shprehitë e parkimit, ndalimi në tabela etj.). ○ pyesni disa prej të punësuarve në lidhje me informacionin e tyre në lidhje me rreziqet dhe masat parandaluese për të shmangur aksidentet e trafikut. <p>* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata.</p> <p>* Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.</p>			
1.	<p>A është kryer vlerësimi i riskut për rreziqet që lidhen me rrugët e trafikut dhe trafikun në vendet e punës?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Është obligim i juaji të siguron vlerësimin e riskut - kontrolloni nëse është kryer dhe dokumentuar.</i> ● <i>Kontrolloni nëse vlerësimi i riskut përmban analiza të rreziqeve që lidhen posaçërisht me rrugët e trafikut dhe aksidentet.</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë marrë masat e nevojshme për t'i shmangur ose zvogëluar këto risqe (p.sh. masat e marra organizative ose teknike).</i> 			
2.	<p>A është ofruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për të punësuarit në lidhje me rrezikun për aksidente në trafik dhe masat e mundshme parandaluese?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 7, 9, 13, 20</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>A ka informacion (të shkruar) në dispozicion dhe të ofruar për të punësuarit (p.sh. materiale, trajnimi, broshura/postera)?</i> ● <i>Kontrolloni nëse informacioni specifik për trajnim (nëse aplikohet) përfshin:</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> ○ rreziqet specifike që lidhen me trafikun, informacioni mbi pikat e veçanta ku mund të ndodhin këto rreziqe, ngarkimi/shkarkimi i sigurt, distancat e sigurisë nga automjetet etj. ● Kontrolloni nëse është ofruar trajnim formal për të punësuarit, duke përfshirë praktikat e sigurta të vozitjes? ● A është përsëritur periodikisht sipas kërkesave ligjore dhe/ose në rastet kur kanë ndryshuar vendet e punës ose procedurat? 			
3.	<p>A ka pasur konsultime me të punësuarit (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me rreziqet e aksidenteve të lidhura me trafikun?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 19</p> <ul style="list-style-type: none"> ● A kanë qenë të përfshirë të punësuarit (dhe/ose përfaqësuesit e tyre) në vlerësimin e risqeve të aksidenteve në trafik dhe planifikimin e masave parandaluese (p.sh. politikat organizative, oraret e mirëmbajtjes, trajnimet për të punësuarit (duke përfshirë trajnim për shkathtësitë e vozitjes, konsultimet etj.). 			
4.	<p>A është krijuar sistemi për njoftimin, regjistrimin dhe hetimin e aksidenteve që kanë lidhje me trafikun, aksidenteve të shpëtuara, dhe sjelljeve jo të sigurta?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 23</p> <ul style="list-style-type: none"> ● A është krijuar sistemi për njoftimin, regjistrimin dhe hetimin e aksidenteve që kanë lidhje me trafikun, aksidenteve të shpëtuara, dhe sjelljeve jo të sigurta (p.sh., procedura, formularët për raportim, procedura e hetimit etj.). ● A ka pasur ndonjë rast të regjistruar dhe a janë marrë masa parandaluese efektive më pas. 			
5.	<p>A përcaktohen dhe ofrohen oraret e rregullta të mirëmbajtjes për të siguruar sigurinë e automjeteve (p.sh. traktorët, pirunart, kamionët, etj.)?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5</p>			

	<ul style="list-style-type: none"> • Është obligim i juaji të siguron kushte të sigurt dhe të shëndetshme të punës në të gjitha aspektet e punës. • Kontrolloni nëse oraret e mirëmbajtjes mbulojnë kontrolle teknike të rregullta dhe në kohë për të gjitha automjetet sipas planit të prodhuesit (p.sh., kontrolli i frenave, dritave, rrjedhjeve të vajit etj.). • Kontrolloni nëse këto orare përfshijnë kontrollin e tipareve të sigurisë së automjeteve (p.sh., dritat e frenave, rripat e sigurisë, strukturat mbrojtëse ndaj përmbysjes, frenat stacionare etj.). 			
6.	<p>A janë zgjedhur PPM-të e përshtatshme për sigurinë në trafik në bazë të vlerësimit të riskut të vendit të punës?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolloni nëse janë zgjedhur PPM-të e duhura për personat e përfshirë në sigurinë e trafikut, p.sh., vozitësit dhe punëtorët që punojnë pranë rrugëve të trafikut ose të përfshirë në ngarkim/shkarkim (p.sh., jelekë sigurie me dukshmëri të lartë, çizme me mbrojtje të gishtërinjve nga çeliku). • Kontrolloni nëse ato u janë siguruar të punësuarve dhe a përdoren në praktikë. 			
<p>Grupi tjetër i pyetjeve analizon rreziqet e mundshme që lidhen me rrugët e trafikut. Ju lutemi përgjigjuni secilës prej pyetjeve dhe kontrolloni nëse janë konsideruar këto aspekte në vlerësimin e riskut dhe nëse ka masa parandaluese të zbatuara në praktikë.</p>				
7.	<p>A janë rrugët e trafikut brenda zonave të punës të përshtatshme për sasinë dhe llojin e automjeteve të përdorura, dhe a janë planifikuar për të shmangur aksidentet?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16 Rregullore (MPMS) 01/2020</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolloni nëse rrugët e automjeteve marrin parasysh karakteristikat dhe madhësitë e automjetit (p.sh., rrugët duhet të jenë 2 herë më të gjera se automjeti më i gjerë për rrugët me një drejtim dhe 3.5 herë - për trafikun me dy kahje) dhe mos të ketë rrezik të dëmtohen aksidentalisht materialet, makineritë, gypat ose kabllot. 			

	<ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse ka hapësirë të mjaftueshme për parkim për të gjitha automjetet.</i> ● <i>Kontrolloni nëse zonat e ngarkimit janë me madhësi të mjaftueshme dhe të shënuara siç duhet.</i> ● <i>Kontrolloni nëse fluksi i trafikut në një drejtim është vendosur dhe shënuar siç duhet për të shmangur lëvizjen në drejtim të gabuar dhe nuk ka nevojë për kthim prapa të automjeteve.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka kthesa të mprehta ose pika të verbra.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka nevojë për pasqyra të fiksuara për kthesa ose gunga rrugësh për të zvogëluar shpejtësinë, dhe nëse ato janë të instaluar.</i> 			
8.	<p>A janë sipërfaqet e rrugëve të trafikut të niveluara, të pastra, të papenguara dhe të përshtatshme për automjete?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16 Rregullore (MPMS) 01/2020</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse sipërfaqet (si të brendshme ashtu edhe të jashtme) janë të niveluara dhe mbahen në rregull (p.sh., pa vrime ose çarje, etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse sipërfaqet janë pa mbeturina ose materiale të shpërndara, dhe të papenguara.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka ndryshime në nivelin e sipërfaqeve.</i> 			
9.	<p>A është vendosur numër i mjaftueshëm i shenjave paralajmëruese për t'i shënuar rrugët e trafikut?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p> <p>* <i>Kontrolloni nëse rrugët e trafikut ku mund të dëmtohen punëtorët aksidentalisht, janë të shënuara qartë (të dukshme nga distanca kur afroheni, në lartësinë e duhur) me shenjat “Automjete industriale” dhe “Ndalohet qasja për këmbësorë”.</i></p>			

	<div style="text-align: center;">   </div> <p style="text-align: center;">“Automjete industriale” " Ndalohet qasja për këmbësorë”</p> <p><i>* Kontrolloni nëse zonat e punës dhe vendkalimet ku ndalohet vozitja e automjeteve industriale, janë të shënuara qartë (duken nga distanca kur afroheni, në lartësinë e duhur) me shenjat “Ndalohet qasja për automjetet industriale”.</i></p> <div style="text-align: center;">  </div> <p style="text-align: center;">“Ndalohet qasja për automjete industriale”</p> <p><i>* Kontrolloni nëse rrugët e trafikut kanë kufij të shpejtësisë të përcaktuar qartë me shenja të përshtatshme (p.sh., 10 ose 20 km/orë).</i></p>			
10.	<p>Rrugët e brendshme dhe të jashtme të trafikut (nëse vlen), a janë shënuar me shirita të vazhdueshëm në një ngjyrë të qartë dhe të dukshme të sigurisë, duke marrë parasysh ngjyrën e dyshemesë/tokës?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.5, Shtojca V</p> <p><i>* Kontrolloni rrugët e trafikut ku operojnë pirunarët, kamionët, traktorët etj. Zgjedhja e ngjyrës varet nga objekti - duhet të zgjidhet ngjyra më e dukshme (preferohet e bardhë ose e verdhë, e kuqe – si alternativë).</i></p> <div style="text-align: center;">   </div>			
11.	<p>A janë rrugët e këmbësorëve të sigurta për lëvizje brenda vendeve të punës?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p>			

	<p>Rregullore (MPMS) 01/2020, Neni 16, 32</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse rrugët për këmbësorë janë planifikuar mirë për të siguruar qasje në të gjitha zonat dhe për të shmangur rrugët e trafikut për automjetet.</i> ● <i>Kontrolloni nëse rrugët për këmbësorë janë me gjerësi të mjaftueshme në varësi të sasisë së trafikut por të paktën 1 m për korridoret dytësore dhe 1.5 m për korridoret kryesore.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ato dallohen qartë dhe janë të ndara nga rrugët e trafikut</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka vendkalim për këmbësorë të shënuar qartë në rrugët e trafikut të automjeteve.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka pika të verbra për këmbësorët (p.sh., zonat ku vozitësit nuk mund t'i shohin).</i> ● <i>Kontrolloni nëse ato mirëmbahen, mbahen në rregull (p.sh., pa pllaka të dëmtuara, vrima dhe çarje, etj.), dhe pa pengesa.</i> 			
12.	<p>A janë automjetet të sigurta për përdorim?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse automjetet e përdorura (p.sh. traktorët, pirunarët, kamionët etj.) janë të përshtatshme për detyrat e kërkuara (p.sh., jo tepër të mëdha/të vogla, me kapacitet të mjaftueshëm bartës dhe shpejtësi, etj.)</i> ● <i>Kontrolloni nëse të gjitha automjetet servisohehen efektivisht dhe janë të pajisura me frena parkimi?</i> ● <i>Kontrolloni nëse të gjitha automjetet janë të pajisura me rripa sigurie dhe nëse ato përdoren në praktikë.</i> ● <i>Kontrolloni nëse të gjitha automjetet janë të pajisura me pasqyra anësore efektive, sensorë dhe drita për kthim mbrapa, drita paralajmëruese (p.sh. llampa ndezëse) dhe sisteme zanore (p.sh. bori).</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë kryer kontrollet themelore të sigurisë para përdorimit të automjetit.</i> ● <i>Kontrolloni nëse është zbatuar sistemi për të siguruar që vetëm vozitësit e autorizuar mund të kenë qasje në automjete (p.sh., çelësat nuk lihen në pjesën ku ndizet vetura, vozitësit mbajnë bexhe të ndryshme etj.).</i> 			

13.	<p>A ka ndriçim të mjaftueshëm në rrugët e trafikut dhe vendkalimet për këmbësorë?</p> <p>Rregullore (MPMS) 01/2020 Tabela 2&3</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse të gjitha rrugët e trafikut dhe kalimet këmbësore kanë nivele të mjaftueshme të ndriçimit (qoftë natyral dhe/ose artificial) dhe sistemet e ndriçimit mbahen në rregull.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka sistem ndriçimi emergjent (rezervë) (me minimum 50-100lx) dhe nëse është testuar dhe mirëmbajtur, veçanërisht në rrugët dhe daljet e emergjencës.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka procedurë për zëvendësimin e shpejtë të llambave të djegura ose të dëmtuara.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka ndryshime të papritura në nivelet e ndriçimit (p.sh., midis dyerve dhe shkallëve ose zonave të ngarkimit) ose drita verbuese.</i> 			
-----	---	--	--	--